



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen *Hashim Thaçi dhe të bashkakuzuarit*, më 13 qershor, Administratorja njoftoi Trupin Gjykses se znj. Shiamala (Shyamala) Alagendra Khan u miratua me kusht si bashkëmbrojtëse e Jakup Krasniqit.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 14 qershor, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit në vendime më vete për secilin, dhe konstatoi për të dy të akuzuarit se ekziston ende rreziku që të pengojnë ecurinë e procesit gjyqësor ose të kryejnë krime të tjera.

Në vendimet e tyre, gjykatësit theksuan se emrat dhe të dhënat personale të disa prej dëshmitarëve tejet të cenusëshëm do të vazhdojnë t'i jepen Mbrojtjes dhe me to do të njihen edhe të akuzuarit, dhe se lirimi i një të akuzuari që ka dijeni për informacion të ndjeshëm nuk do të ndihmonte mbrojtjen efikase të dëshmitarëve që ende nuk kanë dhënë dëshmi.

Në këtë drejtim, Trupi Gjykses rikujtoi edhe konstatimet e veta të mëhershme se duket që të akuzuarit u kanë dhënë vizitorëve informacion lidhur me dëshmitë e dëshmitarëve të mbrojtur dhe, në rastin e z. Thaçi, ai përcolli udhëzime për një dëshmitar të ardhshëm lidhur me formën dhe përmbajtjen e dëshmisë që do të jepte.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 14 qershor, Trupi Gjykses rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes për të caktuar një hetues të pavarur lidhur me pretendimet e paraqitura në një letër, të cilat mund të jenë relevante për besueshmërinë e një dëshmitari. Në vend të kësaj, Trupi Gjykses urdhëroi Prokurorinë të hetojë pretendimet në atë letër përpara se dëshmitari në fjalë të japë dëshmi, si dhe të njoftojë gjykatësit, Mbrojtjen dhe Mbrojtësin e Viktimave për konstatimet e hetimit.

Më 18 qershor, në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, Trupi Gjykses rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes për apelimin e vendimit për të pranuar me shkrim disa prej dëshmimeve të dëshmitarëve me qëllim thjeshtimin dhe shpejtimin e gjykimit.

Po në të njëjtën ditë, Trupi Gjykses rrëzoi edhe kërkesën e përbashkët të Mbrojtjes për tre ndryshime në Urdhrin e gjykatësve mbi Zhvillimin e Gjykimit, lidhur me seancat përgatitore të dëshmitarëve. Trupi Gjykses konstatoi se Rregullorja në fuqi dhe Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit përmbajnë garancitë e duhura për të mbrojtur të drejtat e palëve kundërshtarë sa u përket aspekteve të ngritura nga Mbrojtja.

Më 19 qershor, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht kërkesën e Mbrojtjes për kohë shtesë për t'iu përgjigjur parashtrimeve të Prokurorisë lidhur me faktet e shqyrtuara në procese të tjera. Termi "fakte të shqyrtuara





në procese të tjera” u referohet aspekteve që kanë lidhje me gjykimin dhe për të cilat është vendosur në procese të tjera gjyqësore, qoftë nga DHSK-ja apo nga gjykata të tjera.

Më 13 qershor 2024, Kryetarja e DHSK-së, Ekaterina Trendafilova, lëshoi paralajmërimin e fundit për Nasim Haradinajn që të respektojë kushtet e përcaktuara në vendimin e saj të dhjetorit 2023 për modifikimin e dënimit të tij, në bazë të të cilit ai u lirua me kusht në Kosovë. Ky paralajmërim erdhi si rezultat i raportimeve se z. Haradinaj kishte dhënë disa intervista pa kërkuar paraprakisht leje nga Administratorja, siç kërkohet në Vendimin e Kryetares mbi Modifikimin e Dënimit. Gjithashtu, Kryetarja theksoi se z. Haradinaj ishte rikujtuar edhe më herët gjatë këtij viti për kushtet e lirit të tij, veçanërisht sa i takon kontaktit me median dhe deklaratave të drejtpërdrejta apo të tërthorta për DHSK-në.

Kryetarja Trendafilova paralajmëroi se çdo shkelje tjetër nga z. Haradinaj, sado e vogël, do të çojë në anulimin e Vendimit mbi Modifikimin e Dënimit dhe rikthimin e tij të menjëhershëm në objektin e paraburgimit në Hagë, ku do të kryejë pjesën e mbetur të dënimit.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

